



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1059 Prot.

Tiranë, më datë 18.11.2020

VENDIM
Nr. 398, datë 18.11.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 18.11.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit të “Restaurimit të banesës "Sula", Rruga “Tregëtare”, Durrës, brenda kufirit zonë Arkeologjike “A”, aplikues Ermira Jorgo, restaurator dhe person i licencuar në arkeologji Lida Miraj;
2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin e “Restaurimit të banesës "Sula", Rruga “Tregëtare”, Durrës” si dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt;
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2;
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

Arta
Dollani

Digitally signed by Arta Dollani
DN: cn=Arta Dollani, o=Instituti i Monumenteve të Kulturës, title=Direktor i Përgjithshëm, cn=Arta Dollani
Date: 2020.11.19 16:38:55 +01'00'

KRYETAR
Elva MARGARITI

Elva
Margariti

Digitally signed
by Elva Margariti
Date: 2020.11.19
17:33:46 +01'00'